



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

PËR
INSTITUCIONALIZIMIN E MEKANIZMIT KOORDINUES KUNDËR DHUNËS NË
FAMILJE DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË TIJ, NË KOMUNËN E
VUSHTRRIË

Neni 1
PALËT

- I.** Komuna e, adresa në rr. "Adem Jashari" Nr.1, i përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri, kryetari i Komunës së Vushtrrisë.
- II.** Policia e Kosovës Stacioni policor Vushtrri, në tekstin e mëtejme (PK) adresa në Rr. "Çamëria" Nr.7 Vushtrri, i përfaqësuar nga komandanti i Stacionit Policor të Vushtrrisë z. Reshat Kovaçi.
- III.** Prokuroria Themelore në Mitrovicë, përfaqësuese për Vushtrri znj. Natasha Radoviç prokurore për raste kundër dhunës në familje në tekstin e mëtejme (PTHM), adresa në Rr. "Mahalla e Boshnjakëve", Nr. 2.
- IV.** Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtrri në tekstin e mëtejme (GJTHM), adresa në Rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu", Nr. 80, Vushtrri. Koordinator z. Ferki Xhaferi
- V.** Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Komuna e Vushtrrisë, adresa në Rr. "Adem Jashari" Nr. 1, i përfaqësuar nga drejtori z. Bujar Pllana

- VI. Drejtoria Komunale për Arsim, Komuna e Vushtrisë, adresa në Rr. "Adem Jashari" Nr.1, i përfaqësuar nga drejtori znj. Ragbete Krasniqi.
- VII. Qendra për Punë Sociale, në Vushtri adresa në Rr. "Dëshmorët e Kombit" (te Parku), përfaqësuar nga znj. Naime Krasniqi, drejtoreshë e qendrës.
- VIII. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Vushtri,(QKMF),adresa Rr."Çamëria", përfaqësuar nga znj. Luljeta Zahiti, drejtoreshë e qendrës.
- IX. Zyra për Punësim, Vushtri adresa në Rr."Ahmet Selaci" përfaqësuar nga z. Bashkim Asllani, drejtor i zyrës.
- X. Shoqata e gruas "ATO ", Vushtri adresa në Rr. "Wesly Clark", përfaqësuar nga znj. Fikrije Ferizi , drejtoreshë.

Palët bien dakord si vijon:

Neni 2 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Mirëkuptimi është përmirësimi i nivelit të sigurisë dhe efikasitetit për parandalimin, trajtimin dhe ri-integrimin e rasteve të dhunës në familje, duke siguruar në vazhdimësi mirëqenie për këtë kategori personash që janë viktimat¹ të dhunës në familje, përmes institucionalizimit të Mekanizmit Koordinues dhe monitorimit të zbatimit të politikave.

Neni 3 OBJEKTI

Objekt i kësaj Marrëveshje Mirëkuptimi është koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse të sipërshënuara në komunën e Vushtrisë, për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare, përmes institucionalizimit të **Mekanizmit Koordinues** (këtej tutje referuar edhe si "mekanizmi" apo "MK").

¹ **Shënim sqarues:** ndonëse termi "viktimat" nuk konsiderohet i përshtatshëm për t'u përdorur nga profesionistët që punojnë në fushën e dhunës në familje dhe sugjerohet të zëvendësohet me termin "të mbijetuar/a të dhunës në familje", "palë e dëmtuar", e të tjera, në këtë Memorandum Mirëkuptimi, është rënë dakord të përdoret termi "viktimat" për të qenë në linjë me terminologjinë juridike, që përdoret në fushën e dhunës në familje.

Neni 4 BAZA LIGJORE

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi bazohet në Ligjet dhe akte tjera si në vijim:

- 4.1 Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- 4.2 Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;
- 4.3 Ligjin për Ndihmë Juridike Falas;
- 4.4 Ligjin për Ndërmjetësim;
- 4.5 Ligjin për Barazi Gjinore;
- 4.6 Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;
- 4.7 Ligjin për Shëndetësinë;
- 4.8 Ligjin për Regjistrimin dhe Evidencën e të Papunësuarve dhe Punëkërkesve;
- 4.9 Ligjin për familjen;
- 4.10 Ligji për kompensimin e viktimave të krimit;
- 4.11 Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- 4.12 Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
- 4.13 Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje, së bashku me Planin e Veprimit për Dhunën në Familje etj.
- 4.14 Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë, Zyra e Kryeministrit- Agjencia për barazi Gjinore;
- 4.15 Udhëzimi Administrativ, për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje dhe
- 4.16 Udhëzimi Administrativ, për trajtimin e obligueshëm mjekësor të kryesit të dhunës në familje nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope.

Neni 5 ANGAZHIMET E PALËVE

Palët marrin përsipër këto angazhime të përbashkëta:

- 5.1 Emërimi i një koordinatorje lokale që do të lehtësojë punën koordinuese të mekanizmit; *(Sipas shkresës së Koordinatorit Nacional për mbrojtje nga Dhuna në Familje, nr. 01-3949 e datës 17.10.2018, drejtuar kryetarëve të komunave për themelimin dhe funksionalizimin e mekanizmave koordinues institucional për mbrojtje nga dhuna në familje, bashkëlidhur këtij Memorandumi).*
- 5.2 Ngritja dhe fuqizimi i një marrëdhënieje bashkëpunuese ndërmjet institucioneve kryesore përgjegjëse për trajtimin e dhunës në familje, duke shkëmbyer informacione(t);

- 5.3 Hartimi i procedurave dhe protokolleve të përbashkëta për trajtimin në mënyrë specifike të rasteve të dhunës në familje, bazuar në protokollet dhe procedurat ekzistuese të secilit/ës institucion/organizatë pjesë e këtij Mekanizmi Koordinues;
- 5.4 Përcaktimi i kriterëve pjesëmarrëse në Mekanizmin Koordinues për çdo institucion/organizatë që shpreh interes për të qenë pjesë e tij;
- 5.5 Organizimi i takimeve të rregullta koordinuese (çdo tre muaj) si edhe mbledhje në bazë të rasteve (ad-hoc), sipas nevojës;
- 5.6 Identifikimi i rasteve të dhunës në familje nëpërmjet mbledhjes periodike të të dhënave në terren, për të gjitha komunitetet në komunën e Vushtrrisë;
- 5.7 Ndërgjegjësimi i publikut nëpërmjet informacioneve të standardizuara që do të publikohen rregullisht nga anëtarët e Mekanizmit Koordinues (p.sh mbledhje të veçanta të fokusuara në grupe të tilla si të gratë, burrat, të rinjtë, edukimi i nxënësve në shkollat e sidomos në shkollat fillore, e të tjera);
- 5.8 Ofrimi i ndihmës juridike falas për rastet e dhunës në familje;
- 5.9 Ofrimi i mbështetjes psiko-sociale falas për rastet e dhunës në familje;
- 5.10 Trajnimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve profesionale të anëtarëve të Mekanizmit Koordinues, me mbështetjen e OJQ-ve që veprojnë në komunën e Vushtrrisë;
- 5.11 Ngritja e vetëdijes së komunitetit për denoncimin e menjëhershëm të rasteve të dhunës në familje;
- 5.12 Bashkëpunimi me Këshillin Komunal për Sigurinë në Bashkësi;
- 5.13 Qasja në institucione dhe përmirësimi i saj për të gjitha rastet e dhunës në familje;
- 5.14 Organizimi i aktiviteteve lobuese e avokuese për ndryshim, bazuar në informacionin nga monitorimi i punës në terren;
- 5.15 Hartimi i rekomandimeve për qeverisjen qendrore e lokale, për sa i takon ndryshimit të politikave, përfshirë edhe mbështetjen financiare të tyre;
- 5.16 Mbështetja financiare e rasteve të dhunës në familje, nga buxheti komunal;
- 5.17 Trajtimi 24 orë në ditë në 7 ditë të javës, i nevojave të viktimave të dhunës në familje, menaxhimi i rasteve, si dhe ndjekja e tyre deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme;

- 5.18 Rishikimi periodik i përshkrimit të punës së Mekanizmit Koordinues bazuar në kërkime dhe vlerësime të punës së këtij Mekanizmi në terren;
- 5.19 Rishikimi i vazhdueshëm dhe periodik i të dhënave në dispozicion për rastet e dhunës në familje, përdorimi i tyre për të përcaktuar nevojat, identifikimi i pengesave dhe krijimi i zgjidhjeve për çështjet me të cilat përballlet viktimat e hartimi i rregullave dhe i udhëzimeve për ndarjen e informacionit përkatës të viktimës, dhe për mbrojtjen e të drejtës së saj për ruajtjen e informacionit mbi jetën private.

Neni 6

DETYRAT E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

6.1 Komuna e Vushtrrisë merr përsipër:

- 6.1.1 Të luaj rol drejtues në ngritjen, konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e Mekanizmit Koordinues për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- 6.1.2 Të grumbullojë të dhëna të standardizuara mbi dhunën në familje dhe t'ua shpërndajë ato palëve të dhura;
- 6.1.3 Të rrisë mbështetjen financiare për institucionet relevante që trajtojnë rastet e dhunës në familje;
1. 6.1.4 Të orientojë rastet në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas në Prishtinë;
- 6.1.5 Të hartojë aktet e brendshme në kuadër të zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe t'ia paraqesë ato Mekanizmit Koordinues për aprovim;
- 6.1.6 Ta informojë viktimën ose personin që e shoqëron atë mbi shërbimet sociale ekzistuese dhe ta shoqërojë atë për në qendrat e dhura, duke siguruar transportin nëse është e nevojshme.

6.2 Zyrtaria për Barazi Gjinore merr përsipër:

- 6.2.1 Të organizojë dhe udhëheqë takimet e Mekanizmit Koordinues, sipas standardeve operative dhe procedurale të këtij Mekanizmi;
- 6.2.2 Të koordinojë marrëdhëniet bashkëpunuese në mes institucioneve kryesore për adresimin adekuat të viktimës së dhunës në familje;
Shënim sqarues: sipas përshkrimit të punës për Koordinatorin/in e mekanizmit në Aneksin 4.

6.3 Drejtoria Komunale për Arsim merr përsipër:

- 6.3.1 Të zhvillojë ligjëratat të veçanta apo të rekomandojë shkollave për integrimin e kësaj teme në kurset ekzistuese, për tu njohur në mënyrë specifike lidhur me dhunën në familje dhe funksionimin e mekanizmit koordinues;

- 6.3.2 Të garantojë hartimin e një plani pune për fushata vetëdijesimi me qëllim që çdo nxënës të informohet për drejtat ligjore në rastet kur ka dhunë në familje.
- 6.3.3 Të sigurojë që fëmijët të cilët janë viktimë e dhunës në familje dhe strehohen në Strehimoren “Raba Voca” në Mitrovicë të ju garantohet vijueshmëria në shkollën më të afërt dhe të sigurohet që po trajtohet mirë nga shkolla.
- 6.3.4 Të raportojë rastet e identifikuara të dhunës në familje, tek Mekanizmi Koordinues;
- 6.3.5 Të kujdeset për zbatimin e urdhrave mbrojtës, kur këto përcaktojnë detyrime për dhunuesin për të mos kontaktuar fëmijët apo për të mos iu afruar godinave të tyre arsimore (kopshte, shkolla, etj). Në rast të shkeljes së këtyre urdhrave mbrojtës, drejtuesi/ja i institucionit duhet të njoftojë menjëherë policinë.

6.4 Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale merr përsipër:

- 6.4.1 T’ju japë prioritet në shërbime mjekësore në mjekësinë familjare dhe t’i lirojë nga participimi viktimat e dhunës në familje;
- 6.4.2 Të referojë tek anëtarët e Mekanizmit Koordinues rastet e rrezikut (potenciale) të dhunës në familje;
- 6.4.3 Ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet e dhunës në familje, brenda territorit të komunës;
- 6.4.4 Të trajtojë me prioritet rastet e dhunës në familje në kuadër të riintegrit të tyre (p.sh duke vënë në dispozicion banesa sociale të tjera).

6.5 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim merr përsipër:

- 6.5.1 Të ndihmojë Mekanizmin Koordinues në planifikimin e hapave konkretë për përcjelljen e informacionit mbi ekzistencën dhe punën e këtij Mekanizmi, tek të gjitha komunitetet me pakicë;
- 6.5.2 Të sigurohet që të gjitha rasteve të dhunës në familje që mund të adresohen tek Mekanizmi Koordinues nga komunitetet me pakicë, të trajtohen me të njëjtin prioritet dhe me qasje të barabartë, si të gjitha rastet e tjera të dhunës në familje;
- 6.5.3 Të ndihmojë në lehtësimin e kontakteve mes komuniteteve me pakicë dhe anëtarëve të Mekanizmit Koordinues, përmes ndërtimit të besimit të ndërsjellë ndërmjet tyre;
- 6.5.4 Të marrë masa për vlerësimin paraprak të rasteve potenciale të dhunës në familje në komunitetet me pakicë dhe t’ia referojë këto raste Mekanizmit Koordinues;

Neni 7
POLICIA E KOSOVËS MERR PËRSIPËR

- 7.1 Të koordinojë dhe bashkërendojë veprimet e veta me anëtarët e Mekanizmit Koordinues, në funksion të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje si dhe detyrave të parapara komfor këtij Ligji².

Neni 8
PROKURORIA THEMELORE NË MITROVICË MERR PËRSIPËR

- 8.1 Të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin në trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- 8.2 Të mbështesë punën e Mekanizmit Koordinues nëpërmjet trajtimit me prioritet të rasteve të dhunës në familje.

Neni 9
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI MERR PËRSIPËR

- 9.1 Të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin në trajtimin sa më të shpejtë të rasteve të dhunës në familje;
- 9.2 Të ndihmojë Mekanizmin Koordinues duke dhënë informacionin e nevojshëm të lidhur drejtpërsëdrejti me funksionimin e këtij Mekanizmi;
- 9.3 Të sigurojë informacionin e domosdoshëm për anëtarët e tjerë të Mekanizmit Koordinues, për të garantuar procedura efikase brenda gjykatës, për viktimat;
- 9.4 Të mbajë në konsideratë faktin që një vendim i dhënë nuk ndikon vetëm tek rasti që shqyrtohet, por jep mesazhe vetëdijësuese (pozitive ose jo) në të gjithë popullsinë.

Neni 10
AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS MERR PËRSIPËR

- 11.1 Të ofrojë shërbime juridike falas në pajtim me ligjin përkatës, duke iu dhënë prioritet rasteve të dhunës në familje;
- 11.2 Të ndajë me anëtarët e tjerë të Mekanizmit Koordinues të dhënat për rastet e dhunës në familje që kanë kërkuar dhe përfituar shërbim ligjor falas, si edhe për llojin e shërbimit të ofruar;

² Për më shumë detaje në lidhje me këtë nen, ju lutemi referohuni tek paraqitja e plotë e tij, bashkëlidhur këtij Memorandumi si Aneks 1.

- 11.3 Të koordinohet rregullisht me anëtarët e Mekanizmit Koordinues me qëllim që të ofrohet një ndihmë juridike sa më efektive;
- 11.4 Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Mekanizmit Koordinues, të organizojë fushata të vetëdijesimit juridik, me fokus grupe të veçanta, që mendohet se janë më të prekura nga dhuna në familje.

Neni 11

QENDRA PËR PUNË SOCIALE MERR PËRSIPËR

- 12.1. Të koordinojë veprimet e veta me anëtarët e Mekanizmit Koordinues në funksion të zbatimit të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare me Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e tij, si edhe të Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.
- 12.2. Të angazhohet, pas njoftimit nga policia, të fillojë procedurat për mbështetjen e rastit;
- 12.3. Të mbrojtë dhe vendosë viktimën në një lokacion të sigurt (strehimore) ku dhuna nuk mund të përsëritet;
- 12.4. Të sigurojë forma të ndryshme të mbështetjes për viktimat e dhunës në familje, përmes këshillimeve, ndërmjetësimit, koordinimit të veprimeve ndër-institucionale dhe shërbimeve tjera të nevojshme për viktimat;
- 12.5. Mbrojtë grupet e veçanta viktimat të dhunës në familje, si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit/atë etj;
- 12.6. Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë

Neni 12

QENDRA E MJEKËSISË FAMILJARE MERR PËRSIPËR:

- 13.1 Të sigurojë kujdes mjekësor të menjëhershëm dhe konfidencial sipas nevojës së viktimës, duke vënë në dijeni organet përkatëse, sipas rastit;
- 13.2 T'i trajtojë me përparësi viktimat për nevojat e tyre shëndetësore dhe të sigurojë shëndetin e tyre;
- 13.3 Të trajnojnë në mënyrë të vazhdueshme e sipas një plani specifik, të gjithë personelin mjekësor në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe detyrimet e përgjegjësitë edhe në kuadër të bashkëpunimit me Mekanizmin Koordinues;
- 13.4 Të marrë pjesë në Mekanizmin Koordinues për të ofruar konsulencë mjekësore dhe perspektivë për zhvillimin një reagimi të plotë për viktimat;
- 13.5 Të trajnojnë personelin tjetër mjekësor për identifikimin e dhunës në familje dhe të sigurojnë burimet dhe shërbimet për viktimat që mund të kërkojnë ndihmë, pa i bërë publik emrat e tyre.

Neni 13
ZYRA KOMUNALE E PUNËSIMIT MERR PËRSIPËR

- 14.1 Të regjistrojë dhe evidentojë rastet e dhunës në familje në evidencën e Punëkërkesve dhe të Papunëve;
- 14.2 Të trajtojë me prioritet rastet e dhunës në familje duke iu ofruar atyre:
 - 14.2.1 Këshillim për punësim;
 - 14.2.2 Këshillim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim të përgatitjes për nevojat e tregut të punës;
 - 14.2.3 Ofrimi i ndihmës teknike dhe profesionale për aplikim të suksesshëm për vende pune;
 - 14.2.4 Mbështetje në ndërmjetësim në punësim me qëllim të ri-integrimit, përmes programeve dhe projekteve të ndryshme.

Neni 16
OJQ “ATO” MERR PËRSIPËR

- 16.1 Të ofrojë ndihmë falas për rastet e dhunës në familje;
- 16.2 Të organizojë fushata vetëdijësuese në lidhje me dhunën në familje dhe legjislacionin ekzistues;
- 16.3 Të ndihmojë punën e Mekanizmit Koordinues.
- 16.4 Hulumtimi i zbatueshmerisë së Ligjit kundër Dhunës në Familje
- 16.5 Monitorimi i institucioneve për zbatueshmerinë e Ligjit kundër Dhunës në Familje.

Neni 18
PERSONAT E KONTAKTIT

- 18.1 Secila nga palët e përfshira në këtë Memorandum Mirëkuptimi përcakton nga një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura. Emri dhe kontaktet e këtij personi duhet të vihen në dispozicion të Komunës, *jo më vonë se dhjetë (10) ditë* nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Lista e përfunduar e këtyre kontakteve (me detaje të tilla si emër mbiemër, numër telefoni, adresë e-maili, adresë postare, e të tjera) do të shtohet si aneks 2 i kësaj Marrëveshjeje, bazuar në këtë nen;

- 18.2 Palët duhet të venë në dispozicion informacionin e kërkuar për rastet e dhunës në familje që trajtojnë çdo muaj, jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës. Informacioni mund të dërgohet tek **Zyrtarja/i për Barazi Gjinore** nëpërmjet adresës së e-mailit ose mund t'i dorëzohet dorazi asaj/atij, në bazë të një kontaktimi paraprak;
- 18.3 Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës gjithashtu dhe për saktësinë e protokolleve, procesverbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që ka të bëjë me informacionin e dhënë.

Neni 19

TAKIMET DHE RAPORTIMET

- 19.1 Mekanizmi Koordinues do të mbajë takimet e veta të rregullta në funksion të përmirësimit të komunikimit, koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve;
- 19.2 Gjatë këtyre takimeve do të diskutohen rastet e dhunës në periudhën kohore të mbuluar që nga takimi i mëparshëm, do të diskutohen dhe vendoset për iniciativa të përbashkëta për vetëdijësim, avokim, hulumtim, e të tjera. Duhet të ceket që, për shkak të përbërjes së zgjeruar të grupit, diskutimi për rastet e dhunës duhet të zhvillohet duke ruajtur plotësisht identitetin e viktimave dhe ushtruesve të dhunës. Për këtë synim, grupi do të respektojë të gjitha ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- 19.3 Ftesat dhe rendi i ditës për takimet e rregullta do të dërgohen të paktën dhjetë ditë para takimit. Para kësaj periudhe, anëtarëve do iu kërkohej të dërgojnë pika të rendit të ditës në rast se kanë sugjerime për këtë aspekt. Për shkak të eliminimit të pengesave burokratike, pikat në rendin e ditës mund të shtohen edhe ditën e takimit me pajtim të shumicës së anëtarëve që marrin pjesë.
- 19.4 Përveç takimeve të rregullta të Mekanizmit Koordinues, me kërkesë të një apo më shumë anëtarëve, ai mund të mblidhet edhe në takime të jashtëzakonshme. Ftesa dhe rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme duhet të dërgohet të paktën 24 orë para takimit.
- 19.5 Raportimi në Mekanizmin Koordinues do të kryhet në disa nivele, gjegjësisht:
- 19.5.1. Raportimi i Koordinatorës/it lokal/e para Mekanizmit Koordinues për aktivitetin e saj/tij në periudhën paraprake;
 - 19.5.2. Raportimi i anëtarëve për rastet në terren;
 - 19.5.3. Raportimi i anëtarëve për ndryshimet e nevojshme apo aktivitetet preventive;
 - 19.5.4. Raportimi tek Kryetari i Komunës;
 - 19.5.5. Informimi i Asamblesë Komunale dhe Agjencisë për Barazi Gjinore.
- 19.6. Palët mund sugjerojnë formate të përshtatshme, të krahasueshme edhe me formatet që aktualisht përdorin (në rast se përdorin) për mbledhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje;
- 19.7. Palët duhet të konfirmojnë me shkrim marrjen e raportimit mujor përkatës që përgatitet nga Koordinatorja e Mekanizmit Koordinues Komunal për mbledhjet në lidhje me rastet e

dhunës në familje, si dhe marrjen e proces-verbaleve të mbledhjes, në adresën e e-mailit të sipërpërmendur;

Neni 20
DISPOZITA TË FUNDIT

- 20.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Mirëkuptimi, për të qenë partnerë në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për këtë qëllim;
- 20.2 Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi lidhet pa afat të përcaktuar;
- 20.3 Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi do të rishikohet dhe përmirësohet *pas një viti* nga data e hyrjes së tij në fuqi;
- 20.4 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre;
- 20.5 Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Marrëveshje, janë Aneket bashkangjitur;
- 20.6 Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj në një (1) kopje për secilën palë nënshkruese.

02.04

Nënshkruar me datë: _____ 2021 , në Vushtrri

PALËT NËNSHKRUESE



KRYETARI KOMUNËS SË VUSHTRRIË

z. Xhafer Tahiri

PROKURORIA THEMELORE VUSHTRRI

znj. Natasha Radović

POLICIA E KOSOVËS

z. Reshat Kovaçi

GJYKATA THEMELORE MITROVICË,
DEGA VUSHTRRI

z.

DREJTORIA KOMUNALE PËR SHËNDETËSI
DHE MIRËQENJE SOCIALE

z. Bujar Pllana

DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

znj. Ragbete Krasniqi

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

znj. Naimë Krasniqi

QENDRA KRYESORE MJEKËSISË FAMILJARE

znj. Luljeta Zahiti

ZYRA KOMUNALE E PUNËSIMIT

z. Bashkim Asllani

OJQ "ATO" VUSHTRRI

znj. Fikrije Ferizi

ANEKS 1

Neni 24

Ligji Nr 0/3- L 182, datë 1 korrik 2010 “Për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje”

Përgjegjësitë e Policisë së Kosovës

1. Policia e Kosovës duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje ose shkeljes së urdhrit për mbrojtje apo të urdhrit për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin.
2. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, Policia e Kosovës e ndalon kryerësin e supozuar në pajtim me ligjin.
3. Policia e Kosovës përdor mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën, përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:
 - 3.1. sigurimin e linjës së posaçme telefonike për raportim të dhunës në familje;
 - 3.2. informimin e viktimës, përfaqësuesin ligjor ose mbrojtësin e viktimës për të drejtat e tij në përputhje me këtë ligj, por edhe me të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme sipas nenit 22 të këtij ligji;
 - 3.3. informimin e viktimës lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmave të tjera në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të organizatave joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime për viktimat;
 - 3.4. informimin e ofruesve përkatës të shërbimeve të përmendura sipas paragrafit 3.2 të këtij neni lidhur me ndonjë rast të dhunës në familje dhe mundësimin e kontaktit mes ofruesit të shërbimit dhe viktimës me kërkesën e viktimës;
 - 3.5. sigurimin e transportimit të viktimës dhe vartësve të saj deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontrollim mjekësor;
 - 3.6. sigurimin e transportimit të viktimës, e sipas nevojës edhe vartësve të saj deri në një vendstrehim apo vendqëndrim tjetër të përshtatshëm dhe të sigurt, me kërkesën e viktimës;
 - 3.7. nëse paraqitet nevoja, sigurimin e mbrojtjes për atë që ka lajmëruar dhunën në përputhje me obligimet përkatëse ligjore lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve;
 - 3.8. largimin e të pandehurit nga banesa ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin e palës së mbrojtur apo ndonjë pjese të saj në rastin kur me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente caktohet masa e paraparë në nenin 7 të këtij ligji;
 - 3.9. sigurimin e kontaktit zyrtar për viktimën ose përfaqësuesin e saj ligjor me nëpunësin hetues në kuadër të Policisë së Kosovës nëse kërkohet ndihma e mëtejshme. Nëse mungon nëpunësi hetues, atëherë ndonjë nëpunës tjetër i Policisë së Kosovës duhet t'i ndihmojë viktimës.
4. Policia e Kosovës e përpilon raportin lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra apo jo, a është ndaluar dikush apo jo dhe një kopje të këtij raporti ia japin viktimës, përfaqësuesit të saj ligjor dhe mbrojtësit të viktimës.

5. Nëse viktimë është e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose nuk ka zotësi të veprimit, apo kur veprat e dhunës në familje janë aq të rënda sa ndikojnë në qetësinë a sigurinë e personit të moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet, ose që nuk ka aftësi të plotë të veprimit dhe jeton në banesën e njëjtë, Policia e Kosovës duhet të raportojë për rastin menjëherë në qendrën për punë sociale të komunës ku ai person ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

6. Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një vepër që ka të bëjë me dhunën në familje pavarësisht se a është arrestuar kryerësi ose është gjetur vendndodhja e tij, Policia e Kosovës duhet ta njoftojë rregullisht viktimën apo përfaqësuesin ligjor dhe mbrojtësin e viktimës për gjendjen e hetimeve, duke përfshirë informatat lidhur me vendndodhjen e kryerësit të supozuar ose lirinë e tij a të saj nga burgimi.

ANEKS 2

Lista e Personave të Kontaktit të Mekanizmit Koordinues Komunal në Vushtrri

Emri dhe mbiemri	Institucioni	Telefoni	E-maili

ANEKS 3

Parimet e Mekanizmit Koordinues

Mekanizmi koordinues bazohet në këto parime bazë:

- **Konfidencialiteti** i shërbimeve duhet të ruhet patjetër. Jeta private dhe konfidencialiteti i viktimave duhet të ruhen patjetër;
- **Viktima në qendër të sistemit.** Shërbimet duhet të jenë të orientuara për nga personi në nevojë; nevojat dhe siguria e viktimave duhet të jenë konsiderata parësore;
- **Fleksibiliteti** duhet ta karakterizojë këtë model Mekanizmi Koordinues, me qëllim që të mund të adaptohet në çdo kontekst;
- **Përgjegjësia e dhunuesit.** Dhunuesit duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Anëtarët e Mekanizmit Koordinues duhet ta vënë theksin te kjo përgjegjësi dhe ndërhyrjet duhen bërë me synimin që dhunuesi të mbajë përgjegjësi të plotë;
- **Qëndrueshmëria.** Është shumë e rëndësishme që Mekanizmi Koordinues të ketë qëndrueshmëri, si financiare, ashtu edhe strukturore;
- **Zotërimi të vijë së brendshmi.** Qeverisja Lokale/Komuna duhet ta ndiejë të vetin këtë Mekanizëm Koordinues (d.m.th... ka të drejtë të vendosë si ta përshtatë sipas nevojave), si dhe duhet të sigurojë edhe pjesëmarrjen e OJQ-ve në fazat e planifikimit dhe zbatimit. Modeli duhet të ngrihet mbi kapacitetet dhe burimet ekzistuese të shërbimeve sociale në nivel lokal;
- **Protokolle të standardizuara.** Puna me rastin duhet të orientohet nga disa protokolle të standardizuara mes anëtarëve të Mekanizmit Koordinues;
- **Përputhshmëri me ligjet.** Modeli duhet të jetë në përputhje me legjislacionin për Dhunën në Familje.
- **Siguria.** Çdo plan veprimi që diskutohet si zgjidhje e situatës së viktimave, duhet patjetër të ketë si faktor kryesor sigurinë e tyre. Për shembull, burimet dhe mbështetja e krijuar për viktimat nuk duhet të paraqesë barriera, qoftë edhe të paqëllimshme, dhe nga ana tjetër, nuk duhet të komprometojë sigurinë e tyre. Gjithmonë, kur hartohen protokollat ose trajtohen rastet e dhunës në familje, duhen ngritur pyetje se cilat lloje ndërhyrjesh funksionojnë dhe se çfarë mund të vërë në rrezik apo të rrisë sigurinë e viktimës.

- **Vlefshmëria.** Një faktor kyç në ngritjen e reagimit ndaj dhunës në familje është përcaktimi i procedurave të qarta dhe lehtësisht të përdorshme për secilin anëtar të Mekanizmit Koordinues. Komuniteti duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e këtij Mekanizmi (si reagim i koordinuar ndaj dhunës në familje) dhe strukturave të tij, si dhe duhet të njohë dhe kuptojë detyrat dhe kompetencat e tij.
- **Burimet.** Burimet e Mekanizmit Koordinues janë burimet ekzistuese të institucioneve përbërëse të tij, si dhe të tjera që mund të krijohen si rezultat i financimeve të reja nga buxheti qendror dhe lokal ose nga organizata të ndryshme donatore.
- **Zgjerimi i reagimit.** Një rol i rëndësishëm i mekanizmit është edhe ai i përmirësimit të vazhdueshëm të trajtimit të rastit si dhe zgjerimit të burimeve që i ofrohen viktimave të dhunës në familje. Pas krijimit të grupit të anëtarëve dhe hartimit të protokolleve dhe procedurave, duhet të organizohen mbledhje të rregullta për të diskutuar trajtimin e rasteve individuale të viktimave. Këto diskutime duhet të përqendrohen te procedurat e ndjekura që nga pika e parë e kontaktit me viktimën deri në hapat e ardhshme të menaxhimit të rastit.

ANEKS 4

Përshkrimi i Punës për Koordinatorin/in Lokale/ (Termat e Referencës -ToRs)

Me qëllim krijimin e një reagimi të fortë, efektiv dhe në përputhje me ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, sugjerohet që çdo komunë duhet të ketë një specialist/e të caktuar për këtë çështje, që mund të emërohet si Koordinator/e Lokale. Koordinatori/ja Lokale, nëse është e mundur, duhet të mbajë përgjegjësi vetëm për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje dhe aspektet ndihmuese, lehtësuese të Mekanizmit Koordinues. Sugjerohet që Koordinatori/ja Lokale të ketë një përshkrim pune specifik, ku përcaktohen qartë përgjegjësitë e vendit të saj punës.

Lista më poshtë përmban sugjerime për detyrat e vendit të punës së Koordinatorit/ja Lokale. Kjo listë nuk është përfundimtare, në të mund të shtohen detyra dhe përgjegjësi të tjera, varësisht insitucionit/eve që do mbështesin hapjen e këtij pozicioni pune.

Detyrat dhe përgjegjësitë janë ndarë në dy komponentë: a) Shërbimi ndaj Viktimave dhe b) Shërbimi ndaj Mekanizmit Koordinues.

a) Komponenti për Shërbimin ndaj Viktimave:

Koordinatori/ja Lokale, në lidhje me shërbimin ndaj viktimave të dhunës në familje të cilat paraqiten në komunë për ndihmë, ka si detyrë:

- t'i asistojë viktimat në njohjen e të drejtave të tyre për sa i takon legjislacionit ekzistues të dhunës në familje;
- të krijojë një lidhje të menjëhershme me policinë dhe organet e tjera kompetente për çdo rast të paraqitur;
- të shërbejnë si ndërmjetës me OJQ-të, policinë, shërbimet mjekësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/organizata referimi për t'u dhënë informacion, për t'i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit dhe reagimit;

- të sigurojë burime ose shërbime reference, për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore, këshillim dhe të tjera mbështetje që lidhen me dhunën në familje;
- të sigurohet që viktimat dhe familja e saj të kenë një plan sigurie dhe një plan menaxhimi rasti që i përgjigjet nevojave të tyre afatgjata, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për këtë qëllim;
- të sigurohet që të gjithë viktimave iu mbrohet konfidencialiteti (sugjerohet që në këtë kuadër të sigurohet që familjet të kenë firmosur lejet për shërbime të koordinuara me institucione të tjera).
- të marrë pjesë dhe monitorojë takimet që organizohen nga anëtarët e Mekanizmit Koordinues, për menaxhimin e rasteve specifike;

b) Komponenti i Mekanizmit Koordinues:

Koordinatorja Lokale, në lidhje me mbështetjen e punës së Mekanizmit Koordinues ka si detyrë:

- të marrë iniciativën dhe koordinojë të gjitha takimet e anëtarëve të Mekanizmit Koordinues;
- të ruajë dokumentacionin specifik dhe t’jua shpërndajë atë anëtarëve të Mekanizmit Koordinues pas çdo mbledhjeje të kryer;
- të planifikojë aktivitete të ndryshme, përfshirë edhe ato vetëdijësuese, që mundësojnë suksesin e Mekanizmit Koordinues.
- të paraqesë raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara anëtarëve të Mekanizmit Koordinues dhe aktorëve të tjerë (sikundër është parashikuar në Memorandumin e Mirëkuptimit), në formë të përmbledhur.
- të identifikojë protokolle ekzistuese ose marrëdhënie informale bashkëpunimi që janë të suksesshme dhe t’ia sugjerojë ato Mekanizmit Koordinues;
- të marrë rolin e duhur për të krijuar besimin dhe marrëdhënie pune sa më bashkëpunuese mes saj dhe anëtarëve të Mekanizmit Koordinues;
- të shërbejë si pikë kontakti në komunitet për telefonata dhe kërkesa të ndryshme për informacion;
- të ndihmojë/sugjerojë krijimin e shërbimeve që punojnë gjatë 24 orëve për komunitetin;
- të përgatisë në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse në Komunë, draft protokolle, draft procesverbale, apo draft rregullore të tjera të nevojshme dhe t’ia paraqesë anëtarëve të Mekanizmit Koordinues për plotësim;
- të mbledhë evidencat e rasteve të dhunës në familje të trajtuara në mënyrë të koordinuar dhe t’i ndajë këto evidenca në mbledhjet përkatëse duke respektuar parimet e konfidencialitetit (mbledhja e evidencave, formati, sistemi që do përdoret, etj duhet të jenë aprovuar paraprakisht nga Mekanizmi Koordinues)

